

Vërtetim Vetë-Dëshmues për Pjesëmarrësin në Programin e Ndhmës Urgjente të Ushqimit (TEFAP) (Rishikuar. 23/07)

Ju po konfirmoni në mënyrë gojore që informacioni i mëposhtëm është i vërtetë:

1. Jeni banor i shtetit Connecticut.
2. Ju jeni në limitin ose nën limitin e të ardhurave vjetore totale për numrin e njerëzve të familjes suaj më poshtë:

Tabela e mëposhtme tregon të ardhurat vjetore totale për çdo madhësi të familjes. Nëse të ardhurat e familjes suaj janë ose në limit ose nën limitin e të ardhurave të shënuara për numrin e njerëzve në familjen tuaj, ju i përmbushni kushtet për të marrë ndihma TEFAP.

Madhësia e familjes	1	2	3	4	5	6	7	8*
Të ardhurat vjetore	43,740	59,160	74,580	90,000	105,420	120,420	136,260	151,680

- Për çdo person më shumë, shtoni \$15,420
- Udhëzimet e të ardhurave reflektojnë 300% të limitit federal të varfërisë, që u rifreskua për herë të fundit më 1 korrik 2023.

Ju gjithashtu i përmbushni kushtet për të marrë ndihma TEFAP nëse familja juaj merr pjesë në ndonjërin prej programeve të mëposhtme: Programi Suplementar i Ndhmës me Ushqim (SNAP), Gratë, Foshnjat e Fëmijët (WIC), Ndhimja e Përkohshme për Familjet në Nevojë (TANF ose TFA), Ndhimë me Energji, Programi HUSKY për Ndhimë me Shëndetësi/Medicaid, Programi Seksioni 8 i Ndhmës me Qira, Ndhimja e Përgjithshme e Administruar nga Shteti (SAGA), dhe të ardhurat Suplementare të Sigurimit (SSI).

3. Ju do të raportoni çdo ndryshim të pjesëtarëve të familjes ose të të ardhurave tuaja, para se të vini në vizitën tjetër.

Sipas Ligjit Federal të të drejtave civile dhe Rregulloreve e politikave të Ministrisë Amerikane të Bujqësisë, ky institucion ndalohet së diskriminuar në bazë të racës, ngjyrës, origjinës kombëtare, seksit (duke përfshirë identitetin e gjinisë dhe orientimin seksual), në bazë të paaftësisë, moshës ose për reprezalje apo hakmarrje për aktivitete të mëparshme të të drejtave civile.

Informacioni i programit duhet të vihet në dispozicion edhe në gjuhë të tjera përveçse anglishtes. Personat me paftësi, të cilët kanë nevojë për mënyra alternative komunikimi për ta marrë informacionin e programit (p.sh. kanë nevojë për alfabetin Braj, për shkronja tepër të mëdha, për kasetë me audio, për gjuhën Amerikane të Shenjave), duhet të kontaktojnë agjencinë përkatëse shtetërore ose lokale që administron programin ose Qendrën TARGET të USDA-së në numrin (202) 720-2600 (me zë dhe TTY) ose të kontaktojnë USDA-në nëpërmjet Shërbimit Relay Federal në numrin (800) 877-8339.

Për të ngritur një ankesë diskriminimi ndaj programit, Ankuesi duhet të plotësojë formularin AD-3027, Formularin e Ankesës së Diskriminimit të Programit USDA, i cili mund të sigurohet në internet në: [USDA Program Discrimination Complaint Form](#), që mund të merret nga çdo zyrë e USDA-së, ose duke telefonuar numrin (866) 632-9992, ose duke shkruar një letër që t'i adresohet USDA-së. Letra duhet të përmbajë emrin e ankuesit, adresën, numrin e telefonit dhe një përshkrim me shkrim të veprimit të supozuar diskriminues, në hollësi të mjaftueshme për të informuar Sekretarin e Përgjithshëm për të Drejtat Civile (ASCR) rreth natyrës dhe datës së shkeljes së supozuar të të drejtave civile. Formulari i kompletuar AD-3027 ose letra duhet të dërgohen te USDA me:

1. **postë:**
U.S. Department of Agriculture
Office of the Assistant Secretary for Civil Rights
1400 Independence Avenue, SW
Washington, D.C. 20250-9410; or
2. **faks:**
(833) 256-1665 ose (202) 690-7442; ose
3. **email:**
program.intake@usda.gov

Ky institucion është një institucion i mundësive të barabarta.

Ky dokument është siguruar në lidhje me marrjen e Ndhmës Federale nga Programi i Ndhmës Urgjente të Ushqimit (TEFAP). Zyrtarët e programit duhet ta verifikojnë atë çka është vetë-dëshmuar në këtë dokument. Juve ju është dhënë ky dokumentacion si miratim i deklaratës suaj të përmbushjes së kushteve. Certifikimi i rremë mund të rezultojnë në pagesën mbrapsht të Agjencisë Shtetërore për vlerën e ushqimeve që ju janë dhënë në mënyrë të parregullt, dhe mund të rezultojë në ndjekje penale civile ose kriminale sipas Ligjit Shtetëror ose Federal.